

herët. Në fshat kanë mbetur vetëm disa persona të moshuar, në mesin e të cilëve edhe Agushi dhe Qazimi. Ky i dyti ishte gati tërësisht i verbër. Qëndronin në shtëpinë e Qazimit. Tri ditë më vonë, djemtë e Agushit dhe Qazimit, së bashku me disa komshinj, u kthyen në fshat. I gjetën trupat e pajetë të Qazimit dhe Agushit te dera hyrëse të shtëpisë së Qazimit. Që të dy ishin ekzekutuar me armë zjarri. U varrosën në të njëjtën ditë në varrezat e Lubiqevës/Ljubiçevo.

Burimet: deklarata M.P, FDH-9237; deklarata A.K, FDH-9235; deklarata R.K, FDH-12319.

Nesim (Esat) Krasniqi

(9.06.1930, shqiptar nga Lubiqeva/Ljubiçevo, komuna e Prizrenit/Prizren, bujk, shtatë fëmijë, pjesëtar i UÇK-së)

Nesimi jetonte me bashkëshorten Gjylen, të bijën Selimen, të rejën Lumnijën dhe tre nipërit e vegjël [Lubiqevë/Ljubiçevo]. Të bijtë Ahmeti, Ajeti dhe Ismeti i punonin jashtë vendit, ndërsa vajzat i kishte të martuara. Nesimi aderoi në UÇK në fillim të vitit 1998. Në mbremjen e datës **1.09.1998**, Nesimi u kthye nga pozicionet e UÇK-së dhe, pastaj, i strehoi Gjylen, Lumnijën dhe fëmijët në një strehimore, në pyll [Lubiqevë/Ljubiçevo]. Pastaj, u kthye që ta merrte Selimen, e cila ishte te vëllai i Nesimit. Ishte kjo hera e fundit kur familjarët e panë Nesimin. Nuk u kthye më. Trupin e tij të pajetë e kanë gjetur banorët e fshatit më 5.09.1998, në shtëpinë e të vëllait Rustemit. E varrosën në të njëjtën ditë në varrezat e fshatit. Pas lufte, më 15.09.1999, mbetjet mortore të Nesimit u rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve të Luftës në Landovicë/Landovica. Një rrugë në Prizren është emërtuar sipas tij.

Burimet: deklarata G.K, FDH-35609; deklarata M.P, FDH-9238; J. Martinsen, *Regjistri...*, FDH-26092.

Fatmir (Nazim) Bojaxhiu

(19.12.1964, shqiptar nga Prizreni/Prizren, punëtor, dy fëmijë)

Reshit (Mahmut) Daqaj

(27.11.1969, shqiptar nga Prizreni/Prizren, punëtor, i pamartuar)

Binak (Mahmut) Daqaj

(27.11.1969, shqiptar nga Prizreni/Prizren, punëtor, i pamartuar)

Reshiti dhe Binaku ishin vëllezër binjakë. Jetonin në shtëpinë numër 49, në rrugën *Boško Milenković*, ndërkaq Fatmiri me bashkëshorten, dy fëmijët, prindërit, vëllezërit Besimin dhe Ilirin me familjet e tyre jetonin në rrugën e njëjtë, por në shtëpi me numër 62 [Prizren]. Në datën **1.09.1998**, rreth orës 6:00, Fatmiri, Reshiti dhe Binaku, së bashku me Fevziun, Gjenkerin dhe Bashkimin shkuan në pyllin e afërt për të ngarkuar dru, duke mos ditur se, po atë ditë, kishte filluar ofensiva serbe kundër fshatrave përreth qytetit [rajoni *Vërrini*]. Fatmiri, Reshiti dhe Binaku ishin duke ecur përmes *Malit të Ymerit/Imerova şuma* [**Prizren**] dhe përpara tre burrave të tjerë, kur dikush u bërtiti "*stoj*" (ndaluni). Fevziu, Gjenkeri dhe Bashkimi ikën menjëherë me vrap. Nuk dinin se çfarë kishte ndodhur me Fatmirin, Reshitin dhe Binakun. Pas disa ditësh, miqtë e Fatmirit, Avdyli dhe Shabani, shtëpia e të cilëve gjendet përkaj pyllit, i kanë gjetur trupat e pajetë të Fatmirit, Reshitit dhe Binakut. I njoftuan menjëherë familjarët. Pasi e siguruan lejen e policisë, familjarët shkuan më 7.09.1998 që t'i merrnin trupat e të vrarëve. Ishin të masakruar. Fatmiri, Reshiti dhe Binaku u varrosën po atë ditë në varrezat e qytetit.

Burimet: deklarata B.B, FDH-34785; USCG KGDH, *Regjistri...*, FDH-8817; SMIP, *Terroristički...*, III, 139; KMKRF, *Personat...*, FDH-10832; *Around 50 Albanians Killed in Kosova Since Last Weekend*, pasqyra e lajmeve, KIC, 08.09.1998, FDH-29554; *Three Albanians Killed and Mutilated by Serb Forces, Buried in Prizren*, pasqyra e lajmeve, KIC, 08.09.1998, FDH-29554.

Hatmone (Rexhep Buduri) Shala

(1922, shqiptare nga Hoça e Qytetit/Hoça Zagradaska, komuna e Prizrenit/ Prizren, amvise, shtatë fëmijë)

Hatmonja e moshuar me bashkëshortin Feratin jetonin në bashkësi familjare me djalin Fatmirin me familje [Hoçë e Qytetit/Hoça Zagradaska]. Fatmiri ka qenë i